



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr. 2018 Prot

Vlorë, më 30.12.2024

VENDIM

Nr. 23, datë 24.12.2024

PROPOZIM PËR DHËNIE SHITESE PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 24.12.2024 në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, nenit 5 të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, pikës 4 dhe 5 të VKM - së Nr. 429, datë 12.09.2002 "Për kushtet e përfitimt, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore" i ndryshuar, si dhe kërkesës së Z. Xhorxhi Thoma Vasili për përfitim shtese pensioni të posaçëm shtetëror, protokolluar me tonën Nr. 1825 Prot, datë 19.11.2024,

VENDOSI:

1. T'i propozojë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhënien e shtesës së Pensionit të Posaçëm Shtetëror Zotit Xhorxhi Thoma Vasili, për kontributin dhe angazhimin e tij në fushën e arsimit dhe jetës publike. Për cilësitë e spikatuara pedagogjike, aftësitë drejtuese e organizative në arsimin sarandjot dhe vlerat e larta njerëzore.

2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari dhe Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social/ Sektori i Ligjshmërisë, Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit të Territorit në Këshillin e Qarkut Vlorë.

3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretar i Këshillit të Qarkut

Vllasi Nasaj

Jurist

Alina Myrtaj



KRYETARI

Ervis Moçka



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT VLORË

RELACION

Të Ndërnar Këshilltarë!

Në mbështetje të nenit 5 të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar si dhe pikës 4 e 5 të VKM - së Nr. 429, datë 12.09.2002 "Për kushtet e përfuturimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore" i ndryshuar, Pensionin e Posaçëm Shtetëror e përfitojnë ata persona që:

- a) Kanë marrë pjesë në lëvizjen e Rilindjes Kombëtare, në lëvizjet popullore, në luftën kundër pushtuesve nazifashistë brenda dhe jashtë Shqipërisë, në mbrojtjen e kufirit e ruajtjen e integritetit territorial të Shqipërisë, në lëvizjen demokratike dhe që kanë merita të veçanta;
- b) Kanë arritur rezultate të dallueshme në fushën e shkencës, kulturës, arteve, ekonomisë dhe politikës;
- c) Kanë vuajtur nga persekutimi politik nën regjimin komunist.

Pensionin e Posaçëm Shtetëror e përfitojnë personat të cilët përmbushin kushtet e sipërpërmendura si shtesë mbi pensionin që u takon nga Sigurimet Shoqërore, ose si pension nëse nuk përfitojnë pension nga Sigurimet Shoqërore.

Në mbështetje të bazës ligjore të sipërpërmendur z. Xhorxhi Thoma Vasili, i lindur më 16.09.1943 Tiranë, dhe banues në Sarandë mbështetur nga një grup intelektualësh dhe aktivistësh nga ky qytet ka paraqitur kërkesë pranë institucionit të Këshillit të Qarkut Vlorë për përfutim shtesë Pensioni të Posaçëm Shtetëror, protokolluar me tonën Nr. 1825 Prot, datë 19.11.2024.

Kërkesa drejtuar institucionit të Këshillit të Qarkut Vlorë mbështetet në punën e palodhur, kontributin e vyer në edukimin e shumë brezave nxënësish, si mësues dhe drejtues i suksesshëm, veçanërisht si specialist dhe metodist i një niveli të lartë në fushën e matematikës.

Zoti Vasili për rreth 40 vite ka kryer detyrën fisnike të edukimit të brezave të rinj si mësues matematike. Gjatë viteve të ushtrimit të profesionit z. Vasili ka spikatur si metodist, i përpiktë, novator, me dije dhe kontribute në fusha të ndryshme të jetës publike në qytetin e Sarandës dhe jo vetëm. Ai ka drejtuar për shumë vite gjimnazin "Hasan Tahsini" si dhe Kabinetin Pedagogjik. Kontributi i këtij matematicieni është i vyer në kualifikimin e mësuesve, organizimin e olimpiadave, modernizimin e bazës



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT VLORE**

materiale të shkollave dhe arritjen e niveleve të larta të nxënësve të përgatitur nga vetë.

dhe pas daljes në pension aktiviteti i tij nuk ka ndalur duke u angazhuar në ngritjen e muzeut të shkollës, dhomës teknike, hartimin dhe botimin e historikut të shkollës, realizimin e dokumentarëve dhe emisioneve televizive. Është veprimtar i shquar shoqëror duke dhënë përvojën dhe kontributin e tij në fusha si arsimit, kultura, sporti, muzeologjia, gazetaria, etj. Ka botuar mjaft shkrime, referata, kumtesa, studime metodike në gazeta dhe revista arsimore, botues i disa librave. Një ndër intelektualët më të nderuar të qytetit të Sarandës, vlerësuar maksimalisht nga institucione, personalitete dhe shoqata të ndryshme.

**Bashkëlidhur kërkesës/propozimit gjendet dokumentacioni i mëposhtëm:**

- Jetëshkrimi;
- Propozim nga një grup intelektualësh dhe aktivistësh nga qyteti i Sarandës, Vlorës dhe Tiranës;
- Certifikatë personale, me datë 06.11.2024;
- Certifikatë familjare, me datë 04.04.2024;
- Fotokopje letërnjoftimi elektronik;
- Vërtetim për lloj dhe masë pensioni nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, datë 06.11.2024;
- Kopje e noterizuar e Titullit "Mjeshtër i Madh" dhënë nga Presidenti i Republikës me Nr. Dekreti 13157, datë 07.07.2021 me motivacion "Në vlerësim të kontributit dhe angazhimit të tij të shquar në fushën e arsimit dhe të jetës publike. Për cilësitë e spikatura pedagogjike si mësues matematike dhe afërsitë drejtuese e organizuese në arsimin sarandjot. Intelektual aktiv, gazetar, kronikan sportiv, botues dhe rrëfimtari i rrallë i historive sportive të qytetit të Sarandës";
- Kopje e noterizuar e Titullit "Naim Frashëri" i Artë, dhënë nga Presidenti i Republikës me Nr. Dekreti 7617, datë 10.07.2012 me motivacion "Për kontribut të vyer në edukimin e shumë breza nxënësish, si mësues dhe drejtues i suksesshëm, veçanërisht si specialist dhe metodist i një niveli të lartë në fushën e matematikës";
- Kopje e noterizuar e Medaljes "Naim Frashëri", dhënë nga Presidiumi i Kuvendit Popullor të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, me Nr. Dekreti 6979, datë 30.07.1985 me motivacion "Është dalluar për arritje të mëdha në procesin mësimor - edukativ, për zbatimin e metodave të reja pedagogjike dhe për përdorimin me efektivitet të bazës materiale në shkollë";
- Kopje e noterizuar e Distiktivit "Mësues i dalluar", dhënë nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës, me motivacion "Është dalluar për përgatitje të mirë ideologjike, shkencore e



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI I QARKUT VLORË**



pedagogjike, për punë të ndërgjegjshme dhe për arritje të larta në procesin mësimor - edukativ”;

- Kopje e noterizuar e “Fletë Nderi”, dhënë nga Ministria e Arsimit, më datë 20.05.1988, me motivacion “Për ndihmesë dhe punë të palodhur në organizimin dhe zhvillimin me sukses të finaleve të olimpiadës së IX- të kombëtare të matematikës për shkollat e mesme që u zhvilluna në qytetin e Sarandës”;

- Kopje e noterizuar e çmimit “Anton Mazreku” për gazetarinë sportive, dhënë nga Shoqata Publicistike “Anton Mazreku” dhe Pedrollo, më datë 20.10.2000, për librin sportiv të vitit 2000 “Kur Iuan Butrinti”.

Duke u bazuar në kërkesën e z. Xhorxhi Vasili, në zbatim të Ligjit Nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të pikës 4 dhe 5 të VKM- së Nr. 429 datë 12.09.2002 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore” i ndryshuar, mendojmë se personi i propozuar plotëson kushtet për të përfituar këtë lloj pensioni.

**Specialist/Jurist**

Alma Myrtaj